



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 74 prot.

Kamëz, më 20.05.2024

V E N D I M

Nr. 59 .Datë 20/05 2024

MBI

“NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË NJË RRUGE NË TERRITORIN E
BASHKISË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë **20.05.2024**, pasi mori në shqyrtim kërkesën për ndryshimin e emërtimit të rrugës; “Macerata” në “Hasan Bruçi” me **Nr.Prot. 3006/1 datë 15.04.2024**, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I :

- 1.Emërtimin “**Hasan Bruçi**” , rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
- 3.Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

